

VENDIM
Nr.744, datë 1.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.255, DATË 27.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FONDIN E EKSELENCËS, PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË
STUDENTËVE E SHKENCËTARËVE TË RINJ, TË SHKËLQYER”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i parë, i shkronjës “a” të pikës 2 të vendimit nr.255, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) studentët, që ndjekin studimet e doktoratës, jashtë shtetit, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare brenda vendit, me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 9.5, për shkencat ekonomike e shoqërore, ose, përkatësisht, mbi 8, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 8.5, për shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit në secilin cikël studimi, si dhe shkencëtarët e rinj, pasi kanë përfunduar studimet e doktoratës, me vlerësim maksimal, kur:”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha